

KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		29 / 12 / 2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/01	-	54 569



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



P R O C E S V E R B A L

I TUBIMIT ME PUBLIKUN

Datë: 24.12.2025
Ora: 11:00
Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Tubimi me publikun, në lidhje me aktivitetet e komunës për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025, u mbajt më 24 dhjetor 2025. Të pranishëm ishin:

Ramiz Lladrovci	Kryetar i Komunës
Endrit Gllareva	Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Publike
Agnesë Kastrati-Bucolli	Drejtoreshë e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik
Petrit Gashi	Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Petrit Sinani	Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit
Nexhmedin Gruda	Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë,
Enver Hoxha	Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Tubimin me publikun e hapi Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, i cili theksoi rëndësinë e këtij takimi si tubimi i dytë dhe i fundit për këtë vit. Ai sqaroi se këto takime shërbejnë për komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe për transparencë në punën e komunës.

Më pas fjalën e mori Kryetari i Komunës, z. Lladrovci, i cili raportoi për punën e realizuar gjatë vitit, duke përmendur projektet e përfunduara dhe rezultatet e arritura. Ai prezantoi edhe projektet që janë në proces dhe ato që pritet të realizohen në periudhën e ardhshme, duke dhënë sqarime për ndikimin e tyre në përmirësimin e infrastrukturës, shërbimeve publike dhe kushteve të jetesës në përgjithësi. Po ashtu, Kryetari theksoi se mosrealizimi i disa projekteve ka qenë si pasojë e kontratave kolektive, nga të cilat kanë pasuar vendime përmbarimore që kanë ndikuar drejtpërdrejt në buxhetin dhe planifikimin e komunës.

Megjithatë, edhe përkundër këtyre vështirësive, Komuna ka arritur të ruajë stabilitetin financiar, të realizojë projekte me prioritet të lartë dhe të sigurojë vazhdimësi në ofrimin e shërbimeve publike. Janë shënuar përmirësime të dukshme në fusha të ndryshme, veçanërisht në infrastrukturën rrugore, ndriçimin publik dhe shërbimet komunale, duke reflektuar përkushtimin e vazhdueshëm të institucioneve komunale për zhvillim dhe mirëqenie të qytetarëve.

Në total, në këtë tubim morën pjesë 31 persona. Prej tyre, vetëm 4 parashtruan pyetje dhe dhanë komente e sugjerime.

Lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara, pjesëmarrësit parashtruan pyetje, ofruan sugjerime dhe dhanë komentet e tyre.

Pyetjet e parashtruara, sugjerimet dhe komentet e dhëna:

Semedin Kiçina	Administrator i fshatit Baicë
Zekë Kluna	Administrator i fshatrave Poklek i Ri dhe i Vjetër si dhe Vasilevë
Kadri Ajazi	Administrator i fshatrave Sankoc dhe Fushticë e Ulët
Xhafer Dobërdolani	Administrator i fshatrave Korroticë e Epërme dhe Fushticë e Epërme

Pyetjet dhe sugjerimet e parashtruara nga të pranishmit ishin kryesisht të njëjta. Ato lidhen me ndriçimin publik, infrastrukturën rrugore, mirëmbajtjen, shtrimin dhe asfaltimin e rrugicave dhe trotuareve, si dhe me ujësjellësin dhe kanalizimin.


Numri dhe përmbajtja e pyetjeve		Përgjigje
3	Ndriçim publik, infrastrukturë rrugore, mirëmbajtje, shtrim dhe asfaltim të rrugicave dhe trotuareve, si dhe në çështjet e ujësjellësit dhe kanalizimit.	Pozitive – Kryetari dhe drejtorët e dikastereve përkatëse.

Numri i komenteve dhe emrat e personave që i dhanë ato
1 – Kadri Ajazi - Administrator i fshatrave Sankoc dhe Fushticë e Ulët

Kadri Ajazi - Administrator i fshatrave Sankoc dhe Fushticë e Ulët, shprehu falënderimet e tij për punën e bërë dhe për realizimin e projekteve gjatë këtij viti. Ai vlerësoi angazhimin dhe përkushtimin e stafit dhe institucioneve komunale në përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve për qytetarët, duke theksuar rëndësinë e këtyre projekteve për zhvillimin e komunitetit dhe për ngritjen e cilësisë së jetës së banorëve. Gjithashtu, Ai inkurajoi vazhdimin e punës me të njëjtin përkushtim dhe bashkëpunim në realizimin e projekteve të ardhshme.

Pas përfundimit të sesionit të pyetjeve, sugjerimeve dhe komenteve të këtij tubimi, Kryetari Lladrovci i falënderoi të pranishmit për kontributin e dhënë, duke theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre aktive në përmirësimin e shërbimeve dhe zhvillimin e projekteve komunale. Ai nënvizoi se sugjerimet dhe komentet e qytetarëve do të merren parasysh në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të ardhshme, duke siguruar një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të frytshëm me komunitetin.

Tubimi me publikun përfundoi në orën 11:30.

Procesmbajtësi:

Arton Hasani



FTESA DHE NJOFTIMET PËRCJELLËSE NË LIDHJE ME TUBIMIN ME PUBLIKUN

Linqet në Ueb-faqe të Komunës: <https://glogoc.rks-gov.net/takimet-publike/>

Linku në rrejtin social Facebook: <https://www.facebook.com/share/p/1DCrF11aZT/>



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-070/01-52064 Datë: 09/12/2025

Në vështrim të nenit 68, Kreu i IX- Demokracia e Drejtpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes së Qytetarëve, pika 68.1, 68.2 dhe 68.3 që ka të bëjë me informimin publik dhe konsultim të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 21, 22, 23, 24, 25 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 18 pika 1, 4, 5. 5.1, 5.2., pika 6, 7,8 dhe 9 të Rregullores Komunale për Transparencë si dhe nenit 17 të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci:

ORGANIZON

Tubim me publikun

Të mërkurën, më 24.12.2025 duke filluar në orën 11:00.

Tubimi me publikun do të mbahet në **Sallën e Kuvendit** dhe ftohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara të Komunës, të marrin pjesë në këtë Tubim Publik duke ju përmbajtur terminin të caktuar më lart.

Në këtë Tubim me publikun përfaqësuesit e Komunës do të informojnë pjesëmarrësit për aktivitetin e Komunës për gjashtëmujorin e dytë të këtij viti, për të arriturat, vështirësitë dhe synimet, si dhe investimet kapitale, ndërsa pjesëmarrësit mund t'u shtrojnë pyetje dhe të japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për gjashtëmujorin e dytë dhe çështje tjera në interes të qytetarëve të Komunës.

Me respekt,



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



Br. 01-070/01- 52064 Datum: 09/12/2025

U skladu sa članom 68, Glava IX – Direktna demokratija i mehanizmi učešća građana, tačke 68.1, 68.2 i 68.3 koje se odnose na javno informisanje i konsultacije Zakona o lokalnoj samoupravi; članovima 21, 22, 23, 24 i 25 Statuta Opštine Drenas; članom 18, tačke 1, 4, 5, 5.1, 5.2, 6, 7, 8 i 9 Opštinske uredbe o transparentnosti; kao i članom 17 Administrativnog uputstva za otvorenu administraciju u opštinama, Predsednik Opštine Drenas, Ramiz Lladrovci:

ORGANIZUJE

Javni Sastanak

U sredu, dana 24.12.2025. godine, sa početkom u 11:00 časova.

Javni sastanak će se održati u Sali Skupštine Opštine. Pozivaju se svi građani i zainteresovani subjekti Opštine da prisustvuju ovom Javnom sastanku, uz poštovanje navedenog termina.

Na ovom Javnom sastanku predstavnici Opštine će informisati učesnike o aktivnostima Opštine tokom drugog šestomesečnog perioda tekuće godine, o ostvarenim rezultatima, izazovima i ciljevima, kao i o kapitalnim investicijama. Učesnici će imati mogućnost da postave pitanja i iznesu predloge izabranim opštinskim predstavnicima u vezi sa realizacijom planiranih projekata za drugi šestomesečni period, kao i o drugim pitanjima od značaja za građane Opštine.

S poštovanjem,



Predsednik Opštine
Ramiz Lladrovci

Lista e pjesëmarrësve:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas








Lista e pjesëmarrësve në Tubimin e dytë me Publikun, datë: 24.12.2025

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia M F	Nënshkrimi
1.	SEMERIN	KICINA	M	Skiguri
2.	LIRIDON HILAKU	MILAKU	F	Ali
3.	Antionna	Bucdli	F	Ali
4.	GRASHIT	ELSHALI	M	Grashit
5.	ARBENITË	RANA PODRIMAN	F	Arbenitë
6.	IBRAHIM HANODAN		M	Ibrahim
7.	AFRIM PROKSHI		M	Arif Prokshi
8.	Agim	Kastrati	M	Agim Kastrati
9.	diuidan Berishe		M	Berishe
10.	SHANAN DORRA		M	Shanan
11.	ARBAN ISTOGU		M	Arban
12.	Antyona Durmishi	Durmishi	F	Antyona
13.	Bishe Dvorani		F	Bishe
14.	Djellib Gjy	Syllig	F	Djellib
15.	Aurela	Sahidi - Halibaj	F	Aurela
16.	XHAFAK	DOBÇEDOLANI	M	Xhafak
17.	XHORI	Higzi	M	Xhori
18.	HABIB	GJASHI	M	Habib
19.	HABIB TAHIRAS	DRENAS	M	Habib
20.	Lokë Klina	DELLKLO	M	Lokë
21.	Blerha	Beusha	F	Blerha
22.	Antan	Hoxhi	M	Antan
23.	Enver Hoxhe		M	Enver
24.	Hekmetudin	Gruda	M	Hekmetudin
25.	PETRI	SHANI	M	Petri
26.	PETKIT	GASHI	M	Petkit

* Në këtë takim, përveç kësaj liste, do të bëhen fotografi dhe, me nënshkrimin tuaj, pajtoheni që fotografiet dhe kjo listë të përdoren për komunikim zyrtar.



27.	Agnesë	Kastrati - Bucolli	F	
28.	Mahamet	Gjoka	M	
29.	ENDRI	GLLAGUA	M	
30.	Bakim	Dobra	M	
31.	Ramir	Lladroci	M	
32.				
33.				
34.				
35.				
36.				
37.				
38.				
39.				
40.				
41.				
42.				
43.				
44.				
45.				
46.				
47.				
48.				
49.				
50.				
51.				
52.				
53.				
54.				
55.				
56.				
57.				
58.				
59.				
60.				
61.				
62.				

* Në këtë takim, përveç kësaj liste, do të bëhen fotografi dhe, me nënshkrimin tuaj, pajtoheni që fotografitë dhe kjo listë të përdoren për komunikim zyrtar.



Pjesëmarrja	
Femra	9
Meshkuj	22
Totali	31

PJESËMARRJA NË BAZA GJINORE - PËRQINDJA




Foto nga tubimi me publikun:



